

Përse shkrihet akulli:

Nxirre në dukje efektin e serrës !

Materialet e pajisjet:

- 2 pjata
- 2 kube akulli të njëjta
- 1 gotë uji e hollë e tejdukshme
- rreze dielli



Ecuria e provës

- Vendosni të dy pjatat afër njëra-tjetrës në një vend ku dielli shkëlqen dhe pa era..
- Vendosni në secilën pjatë nga një kub akulli dhe njerën prej tyre mbuloje me gotën e ujit .



E rëndësishme është që, kubet e akullit të vendosen në pjatë njëkohësisht dhe të dy pjatat të ndriçohen në mënyrë të barabartë nga dielli!



- Prisni disa minuta dhe kontrolloni herë pas here kubet e akullit. Pas 15 minutash - varësisht nga fortësia e rrezeve të diellit e trashësia e kubeve të akullit - diçka duhet të ketë ndryshuar aty.

Përse shkrihet akulli:

Nxirre në dukje efektin e serrës !



Vrojtim:

- Nëse ti akoma nuk vëren ndryshime , atëherë prisni edhe pak. Së paku aq gjatë sa, njëri nga kubet e akullit të shkrihet i gjitha.

Çfarë vini re?

- Kubi i akullit nën gotë shkrihet më shpejt.
- Kubi i akullit pa gotë shkrihet më shpejt.

Keni ndonjë mendim, pse ndodh kjo?



Mos ka të bëjë me efektin e serrës!






Cili është efekti i serrës?

Nëse ju keni ndjekur eksperimentin, kubi i akullit nën gotën e ujit duhet të jetë shkrië pak më shpejt. Kjo ndodh për shkak të ashtuquajturit **efekti i serrës**. Rrezet e diellit depërtojnë në gotë dhe energjia e dritës ngroh ajrin brenda gotës. Pra, brenda gotës është shumë më ngrohtë. Sepse energjia e dritës shndërrohet në energji nxehtësie, këtë tashmë mund ta keni zbuluar në eksperimentin e termocentralit diellor.

Ajri i ngrohtë nuk mund të largohet nga gota e uji, kjo bën që kubi i akullit të shkrihet më shpejt.

Çfarë ka të bëjë kjo me klimën e Tokës??

Efekti i serrës në tokë funksionon njëloj si në eksperiment . Atmosfera e tokës me gazrat e saj formon një shtresë rreth tokës, e cila është e ngjashme me gotën nga eksperimenti ynë. Ajo lejon që rrezet e diellit të kalojnë në sipërfaqen e tokës e ta ngrohin atë . Nxehtësia nga sipërfaqja e tokës mbahet më pas nga shtresa e gazit, e cila ndër të tjera përbëhet edhe nga dioksidi i karbonit.



Kështu mund ta imagjinoni efektin natyror të serrës: nxehtësia pjesërisht mbetet nën atmosferën tonë dhe pjesërisht largohet në hapësirë.



Çfarë ka të bëjë kjo me ne njerëzit?

Ky efekt nuk është vetëm i keq – pa të në tokë do të ishte shumë më ftohtë. Në kohët e fundit nga viti në vit është rritur çlirimi i dioksid karbonit në atmosferë e ka bërë që shtresa e gazit – në këtë rast gota në eksperimentin tonë - lejon më pak të kthej mbrapsht nxehtësi në hapësirë, si pasojë në mënyrë jo të natyrshme ajri rreth nesh nxehet shumë. Për shembull, dioksidi karbonit prodhohet kur udhëtojmë me makinë ose kur ngrohim shtëpitë tona.



Kështu veprojnë njerëzit në efektin e serrës : Sa më shumë CO2 që ne prodhojmë, aq më ngrohtë do të bëhet, sepse aq më pak nxehtësi do të mund të mënjanohet në hapësirë!

Se ku mund të na çojë kjo, këtë mund ta zbulosh ti në eksperimentet tona të radhës tjetër. Tani e dini se :



Që të mos ngohet më tej toka, udhëtoni sa më shumë me biçikletë.